



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Komuna – Municipality

Hani i Elezit



04/ 3488 /2023

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR MUAJIN QERSHOR 2023

Hani i Elezit, 2023

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin qershor 2023, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësi, ka funksionuar kryesisht në tre (3) sektorë:

1. Sektori për buxhet dhe financa,
2. Sektori për të hyra dhe
3. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë muajit qershor kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2023 është në lartësi prej **3,349,715.00Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa.....1,702,823.00 €,
- Mallra dhe shërbime.....465,000.00 €,
- Shpenzimet komunale.....96,500.00 €,
- Subvencione dhe transfere ... 100,000.00 €,
- Shpenzime kapitale985,392.00 €,
- Totali i buxhetit.....3,349,715.00 €.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Përgatitja dhe publikimi i raportit mujor i të hyrave dhe shpenzimeve të muajit maj 2023 dhe publikimi i të njejtit në ueb faqe të Komunës,
- Përgatitja e raportit të punës dhe aktiviteve të Drejtorisë Buxhet dhe Financa për muajin maj 2023 dhe dorëzimi i të njejtit në Kabinetin e Kryetarit si dhe publikimi në ueb faqen e Komunës në formatin PDF dhe ,
- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale të muajit maj,
- Barazimi me Thesar për muajin maj,
- Përgatitja dhe publikimi i borxhit publik për muajin maj në ueb faqe të Komunës,
- Përgatitja dhe alokimi i të hyrave vetanake të muajit maj në vlerë prej 68,994.03 € nëpër programe buxhetore duke u bazuar në planifikimin e të hyrave,
- Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026,
- Mbajtja e tri dëgjimeve buxhetore rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026,
- Publikimi i procesverbaleve të dëgjimeve buxhetore rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026 në ueb faqe të Komunës,
- Publikimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare 2022 nga Zyra Kombëtare e Auditimit në ueb faqe të Komunës,
- Hartimi i Planit të Veprimit të Rekomandimeve të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare 2022 nga Zyra Kombëtare e Auditimit,
- Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026 në Kuvend Komunal,
- Publikimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026 në ueb faqe të Komunës,
- Dorëzimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026 në Departamentin e Buxhetit – MFPT më 30.06.2023,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor,

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR MUAJIN QERSHOR 2023

Kategoritë Buxhetore	Buxheti sipas Ligjit nr. 08/L-193	Realizimi Qershor 2023	%
Paga dhe Shtesa	1,702,823.00	162,387.42	9.5 %
Mallra dhe Shërbime	465,000.00	32,678.54	7.02%
Shpenzime Komunale	96,500.00	2,788.15	2.8 %
Subvencione dhe Transfere	100,000.00	14,370.00	14.3 %
Shpenzime Kapitale	985,392.00	26,899.15	2.7 %
Totali	3,349,715.00	239,123.26	7.13 %

1. SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2023 është në shumë prej 560,121.00 €.

Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsej për muajin qershor 2023 nga të hyrat direkte 20,763.46 € dhe paraqesin 3.7 % € e planit të të hyrave vetanake, ndërsa nga muaji janar deri në qershor gjithsej kemi arkëtuar 165,032.38 € ose 29.4 % nga të hyrat e planifikuara.

Në bazë të drejtorive për muajin prill kemi inkasuar këto të hyra:

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka inkasuar të hyra në shumë prej 10,254.68 €;
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka inkasuar të hyra në shumë prej 583.00 €
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka inkasuar të hyra në shumë prej 3,547.60 €;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike ka inkasuar të hyra në shumë prej 720.00 €;
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka inkasuar të hyra në shumë prej 585.20 €;
- Drejtoria e Urbanizimit ka inkasuar të hyra në shumë prej 3,766.98 €;
- Drejtoria e Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport ka inkasuar të hyra në shumë prej 1,390 €;

Në kuadër të këtij sektori janë kryer këto aktivitete:

- Përpunimi, harmonizimi dhe barazimi i evidencave të detajizuara të të gjitha llojet e të hyrave sipas programeve buxhetore, fondeve dhe kodeve ekonomike në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK),

2. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka pasur këto aktivitete:

- Kemi lidhur dy marrëveshje për pagesë me kosto të faturave të tatimit në pronë,
- Shërbime të rregullta ndaj qytetarëve,
- Plotësimin e Formës së Inspektimit të Tatimit në Pronë për vitin 2022.

Drejtores e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

